

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Konferencën për të Drejtën e Informimit

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), mori pjesë në Konferencën e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit, organizuar nën kujdesin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në bashkëpunim me ministren e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni.



Konferenca e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit u mbajt në Tiranë, në përmblyllje të “Javës së Integritetit 2025”, dhe shërbeu si një platformë kombëtare dialogu, mbi sfidat e institucioneve publike, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, në kuadër të procesit të integritetit evropian.